



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 Nr.60/ 01-12144 /23
Kaçanik 22.05.2023

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Komunitete, me datën 25.05.2023 (e enjte),do të mbahet mbledhja e V (pestë) e rregullt e Komitetit për Komunitete, për vitin 2023. Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës në sallën e Komiteteve, më fillim pune në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq, Ekrem Livoreka, Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Në mbledhjen e V (pestë) të Komitetit për Komunitete, të datës 25.05.2023, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

- 1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
- 2.Ndarja e granteve dhe subvencioneve për OJQ;
- 3.Të ndryshme.

Ju mirëpresim,

Me respekt!

Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-9429/23
Kaçanik, 27.04.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **IV (katërt)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 27.04.2023 (e Enjte). Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës Komunale, në sallën e kuvendit, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës të kësaj mbledhje fillimisht nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Arben Thaqi- OJQ. Në ndërkohë në mbledhje erdhi edhe anëtari, Betim Shala-LDK.

Nga Ekzekutivi i komunës nuk mori pjesë ndonjë zyrtar, ndërkaq i ftuar ishte zyrtari për barazi gjinore, Vedat Dema.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu-Zyrtare e Lartë për punë të KK.

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: Fillimisht i përshëndeti pjesëmarrësit e këtij takimi, konstatoj kuorumin, prezentë në mbledhje janë për momentin katër (4) anëtarë. Anëtari Betim Shala me ka lajmëruar se vjen pas 10 minutave, atëherë e hapi mbledhjen e IV (katërt) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2023, data 27 prill, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete;
2. Të drejtat e qytetarëve të komunës së Kaçanikut;
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete

Aprovoj

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Procesverbali i mbledhjes se III (tretë) të rregullt i Komitetit për Komunitete, u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes se III (tretë) të rregullt i Komitetit për Komunitete të vitit 2023, të datës 23.03.2023 / Lënda : 01Nr.60/01-7053/23.

2. Të drejtat e qytetarëve të komunës së Kaçanikut;

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: Zyrtari për të drejtat e qytetarëve, Vedat Dema nuk është prezentë, edhe pse sa e di unë është i ftuar në mbledhje, megjithatë ne mund t'i ngritëm pyetjet dhe vërejtjet dhe t'i përcjellën. E hapi diskutimin:

z. Arben Thaqi: Për me diskutuar për këtë temë, ne duhet ditur shqetësimet që i preokupojnë komunitetet në fusha të ndryshme. Sa i përket shërbimeve të komunës, unë mendoj se janë në nivel, shërbimet janë të mira në përgjithësi, ndërkaq ngecjet janë në aspektin ligjor të çështja e ekzekutimit të vendimeve. Rasti konkret është, çështja e mos kompensimit tim për pjesëmarrje në mbledhje të Komitetit për Komunitete. Për këtë çështje, nuk jepen arsyet dhe nuk ka transparencë. Shërbimet shëndetësore në QKMF, është një organizim dhe funksionim i mirë, shërbimet kryhen shumë mirë. Edhe të arsimi, organizimi dhe funksionimi i arsimit janë duke funksionuar shumë mirë dhe mund të flasim për një proces të mirë të punës në arsim. Problematikë më e veçantë është HANDIKOS, sepse ende nuk kanë një trajtim të veçantë kjo kategori e personave. Sa kam unë informacion, kjo OJQ nuk ka vend ku me zhvilluar aktivitetet e tyre. Është mirë ne si komitet me bërë një kërkesë në KK që t'i mundësohet një hapësirë kësaj kategorie për zhvillimin e aktiviteteve të tyre, pasi që hapësira të shtëpia e kulturës -pjesa ku i kanë zhvilluar aktivitetet, iu kishte marrë, për shkak të zgjerimit të disa aktivitete tjera aty. Unë e kam parë se HANDIKOS publikisht kanë kërkuar edhe një mbështetje financiare, mendoj se duhet të mbështetet kjo kategori në formë institucionale. Fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara kanë nevojë për një përkrahje me të madhe, sesa krejt kategoritë tjera të shoqërisë, andaj duhet t'iu ofrohet përkrahja e nevojshme. Kur jemi të drejtat e fëmijëve, fëmijët kanë nevojë për mbështetje simbolike, ashtu që duhet me iu krijuar qasje në aktivitetet të ndryshme për zhvillimin e tyre psi ko-fizik. Këto çështje duhet t'i kemi parasysh, ashtu që t'iu krijohet mundësia fëmijëve që t'i zhvillojnë aktivitetet e tyre pa pagesë, për shkak të gjendjes së tyre financiare ekonomike të familjeve në Kaçanik.

z. Betim Shala: Sa i përket të drejtave të qytetarëve të komunës tonë, jemi shumë të pakënaqur. Në krejt botën kur të bëhen do projekte të mëdha për qytetin, bëhen vlerësimet më ndryshe, si kur bëhet një shesh i qytetit, nënkalimi etj. Bëhen debate publike me qytetarë, bëhet njëfarë ankandi publik. Për sheshin e qytetit, është bërë ankandi, por debat publik nuk është bërë, se me u pas bërë debat publik për sheshin, ishte bërë edhe për nënkalimin e hekurudhës. Ne nuk po pyetmi për këto çështje, po vendosë ekzekutivi i komunës se po i kanë votat.

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: Debate janë organizuar për çështje të ndryshme nga ekzekutivi i komunës, por ne anëtarët e KK nuk kemi marrë pjesë. Kur ne nuk marrim pjesë, atëherë edhe qytetarët nuk kanë interesim me marrë pjesë. Debatet publike nuk mund të mbahet me 7 apo 8 vota.

z. Betim Shala: z. Ekrem, Janë do debate publike të cilat zgjojnë interes, si çështja e nënkalimit hekurudhor. Unë edhe në mbledhje të kuvendit ia kam potencuar kryetarin të komunës këtë çështje. Kryetari thoshte se nënkalimi për këmbësor kushton 240 mijë euro, ndërsa për vetura, 6 milion euro. Kjo nuk ka logjikë, kryetari nuk është inxhinier, e ata të cilët i kanë thënë këto shifra, nuk kanë të bëjnë fare me këto punë.

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: U tha se në bazë të studimeve që janë bërë aty, nuk mundet me u realizuar me pak mjete, për shkak të lumit. Mundësia është me u bërë mbikalim në atë pjesë edhe për vetura. Nuk e di se a mundet me u bërë mbikalim nga pjesa të qendra, për me dalë në korzë të qytetit direkt?

z. Betim Shala: Nënkalimi është duke u bërë për këmbësor, por jo edhe për vetura. Unë e kam nënshkruar edhe Peticionin i cili na ka ardhur nga LVV. E kuptoj se nuk realizohet ky projekt, se është i kushtueshëm. Ne kemi bërë kërkesë për një mbikalim të santini, një mbikalim të shkolla. E kuptoj edhe qeverinë edhe komunën që nuk mund të realizohet projekti i nënkalimit edhe për vetura, ndërkaq debatet publike duhet me i organizuar, pavarësisht a mbahen apo jo. Ju z. Ekrem nuk mundeni me paragjykuar se a vijnë qytetarët apo jo në debate publike. Unë për këtë debat ndoshta kisha marrë pjesë, edhe pse në debatet tjera nuk kam marrë.

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: Në trajnimet të cilat i kemi mbajtur për këtë çështje, ky problem është evidentë edhe në komunat tjera, ndërkaq ata fajin ia hedhin komunës. Mosinteresimi i qytetarëve dhe mos angazhimi ynë, dështojnë debatet publike me qytetarë. Në trajnimet e mbajtura, ata na kanë thënë që, secili nga ne që i kemi marrë votat për anëtarë të KK, mundem me i sjellë në debat disa veta.

z. Arben Thaqi: Nuk është mirë vetëm me bërë kritika, qytetarët duhet me qenë të përgjegjshëm me marrë pjesë në debate publike të organizuara, se aty e kanë të drejtën me shprehur shqetësimet e tyre dhe me vendosur. Komuna duhet me qenë bashkëpunues me qytetarët, që debatet e organizuara publike me qytetarë mos me dështuar, duhet me dhënë ide të cilat janë të qëndrueshme. Unë në aspektin profesional nuk e di çështjen e asaj pjese, por bëhet mirë me u ndërtuar nënkalimi për shkak të sigurisë së nxënësve në atë pjesë, sepse ka pasur probleme aty. Unë nuk e di çështjen e buxhetit a mundet me i përballuar komuna dhe studimet sizmike, se të pjesa e lumenjve jo vetëm studime nga fusha e ndërtimtarisë, por duhet bëhen edhe studime gjeologjike, sepse duhet menduar çështjen e tërmeteve, e mos me na ndodhë si në Turqi.

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: Ministri jepte si arsye për ndërtimin e nënkalimit, probleme me lumenjtë Lepenc e Neredime. Komplet autostrada deri në Han të Elezit është nëpër lumë, por krejt çështja është e mjeteve financiare.

z. Betim Shala: Autostrada është e sigurt në tërmete deri 8 ballë të rihterit. Komuna kur e ka bërë projektin, është dashur të projekton edhe për vetura nënkalimin hekurudhor. Ferizaj ka bërë shumë nënkalime. Pjesa të ETC, me këtë projekt ishte mbyllur për qasje, ka mbetur vetëm pjesa e qasjes të ura e konakut.

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: Diskutime tjera nuk ka, atëherë çështjet që u diskutuan në këtë pikë, mbetet t'i përcjellën zyrtarit kompetent. Kalojmë në pikën vijuese:

3. Të ndryshme;

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: Para se me marrë dikush fjalën, unë kam një kërkesë për çështjen e hartimit të Raportit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022. Ne si komitet, duhet të ndajmë punën e hartimit të këtij raporti, ashtu që secili nga ne të përgatitë nga një pjesë të raportit në bazë të procesverbaleve të këtij komiteti dhe në mbledhjen e KK të muajit maj të prezantohet raporti në KK. Nga dhjetë mbledhje të këtij

komiteti, secili nga ne pesë (5) anëtarët e këtij komiteti të përmbledhë aktivitetin e këtij komiteti nga dy mbledhje në bazë të procesverbaleve. Fjala vjen, një anëtar i komitetit të përmbledhë aktivitetin nga mbledhja e parë dhe e dytë e këtij komiteti, tjetri të përmbledhë aktivitetin nga mbledhja e tretë dhe të katërtën, e kështu me radhë.

znj. Arta Avdiu: Mirë është pra secili nga ne të përcaktohem se çka punojmë, se përndryshe unë mundem me punuar një pjesë të cilët ndoshta mund të këtë punuar dikush tjetër. Unë po përcaktohem për aktivitetin e Komitetit për Komunitete për vitin 2022, për dy mbledhjet e fundit të vitit 2022.

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar? Nëse jo atëherë si përfundim i kësaj pike mbetet, Hartimi i Raportit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022. Ashtu siç u kuptuam, secili ka me hartuar pjesën e vet, në mënyrë që nxjerrim Draftin Raportin e këtij komiteti dhe i njëjti t'i prezantohet në Kuvendit të Komunës në mbledhjen e muajit maj 2023.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:47.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka